



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

SHOQËRITË HUAMARRËSE NË ADMINISTRIM

Programi Kombëtar i Praktikave të Punës – Thirrja XI

Shoqëritë Huamarrëse në Administrim (SHHA) njofton të rinjtë e interesuar se është hapur **Thirrja XI e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës**, organizuar nga Agjencia Kombëtare e Rinisë.

Në kuadër të këtij programi, **SHHA ofron 2 (dy) vende për praktikë pune**, duke u dhënë mundësinë profesionistëve të rinj të fitojnë eksperiencë praktike në administratën publike.

Kush mund të aplikojë?

Programi është i hapur për të rinjtë:

- të moshës **21–29 vjeç**;
- të diplomuar në një program studimi të ciklit të parë (Bachelor) ose të ciklit të dytë (Master).

Programi ofron:

- Praktikë pune 3-mujore;
- Kompensim financiar në formën e trajtimit ushqimor;
- Program trajnimi të zhvilluar nga ASPA;
- Mundësi për punësim me kontratë pune 1-vjeçare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Afati i aplikimit

Deri më 16 gusht 2026.

Si të aplikoni?

Aplikimi kryhet **vetëm online** në platformën zyrtare të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës.

["https://praktika.rinia.gov.al"](https://praktika.rinia.gov.al)

Për më shumë informacion mbi kriteret e aplikimit, procedurat, dokumentacionin e nevojshëm dhe detajet e programit, vizitoni faqen zyrtare të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës.

Adresa: Rruga "Kavajës", ish Mjetet Mësimore Tiranë, email: info@shha.gov.al